

Në Stamboll mbahet Samiti i 13-të i Organizatës së Bashkëpunimit Islamik (OBI). **Prodhimi i Brendshëm Bruto i 57 vendeve anëtare të Organizatës që marrin pjesë në këtë samit është 10 trilionë dollarë dhe përbën 11% të të ardhurave të botës.**

Vëllimi i tregtisë së jashtme të vendeve pjesëmarrëse në Samitin Islamik është 4,2 trilionë dollarë dhe korrespondon me 22% të tregtisë botërore me vlerë totale 18,7 trilionë dollarë. Sipas të dhënave të Komitetit të Përhershëm për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Tregtar të Organizatës së Vendeve Islame (COMCEC) për vitin 2014 **vëllimi tregtar i 57 vendeve arrin në 2,1 trilionë dollarë.**

Ndërsa tregtia që vendet e Organizatës së Bashkëpunimit Islamik bëjnë ndërmjet tyre në vitin 2014 është realizuar në shifrën e 393 miliardë dollarëve. Vendet që kanë shkëmbimet më të shumta tregtare ndërmjet tyre janë Emiratet e Bashkuara Arabe (EBA), Turqia, Arabia Saudite, Irani, Indonezia dhe Malajzia.